

TAKIMI I DYTË 2022 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **28.06.2022**.

Mbledhja u përqëndrua në prezantimin dhe diskutimin e dy çështjeve:

- Rregullorja e funksionimit të Komiteteve Sektoriale
- Studimi i Nevojave për Aftësi të tregut të punës në fushën e TIK

Rregullorja e funksionimit të Komiteteve Sektoriale

Mbledhja u hap me prezantimin e rregullores për funksionimin e Komiteteve Sektoriale. Sekretariati Teknik sqaroi se, buxheti i shtetit mbulonte vetëm shpërblimet e anëtarëve të Komitetit dhe se nuk parashikohej buxhet i posaçëm për shpenzime të tjera, si analiza apo studime shkencore specifike. Sekretariati theksoi se, në rastin e zëvendësimit të anëtarëve brenda mandatit, anëtari i ri i emëruar mbulonte vetëm kohën e mbetur të mandatit katërvjeçar. Sekretariati theksoi gjithashtu se, çdo anëtar kishte të drejtë të largohej dhe të zëvendësohej gjatë mandatit katërvjeçar, por u nënvizua nevoja për vëmendje të shtuar në procesin e përzgjedhjes, me qëllim ruajtjen e vazhdimësisë së punës së Komitetit. Sekretariati evidentoi se, anëtarët e institucioneve publike ose private mund të rizgjidheshin. Gjatë diskutimeve për rregulloren, anëtarët e Komitetit propozuan që të specifikoheshin qartë rastet që përbënin konflikt interesi.

Në përfundim të diskutimit, u sqarua se, rregullorja e funksionimit të Komiteteve Sektoriale ishte e publikuar në faqen zyrtare të internetit të AKAFPK-së.

Studimi i Nevojave për Aftësi të tregut të punës në fushën e TIK

Në vijim të mbledhjes u prezantua studimi “*Analiza e nevojave të tregut të punës në fushën e TIK*”, ku u paraqit metodologjia e përdorur, konteksti dhe gjetjet kryesore të studimit. Sekretariati theksoi se, analiza përbënte studimin e parë të atij lloji në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Sekretariati informoi se, për realizimin e studimit ishin përdorur dy lloje pyetësorësh dhe evidentuan rezultatet përkatëse, si dhe grupet e synuara të anketuar.

Sekretariati dhe anëtarët e Komitetit dakordësuan se të gjitha studimet që realizoheshin në fushën e TIK kishin ndikim të drejtpërdrejtë në punën e Komitetit dhe se ato duhet të prezantoheshin në Komitet, me qëllim njohjen e ofertës dhe kërkesës në treg.

Në përfundim të prezantimit, u theksua se, nga analiza rezultonte qartë trendi i nevojave për trajnim dhe arsim profesional në sektorin e TIK. Sekretariati evidentoi se, studimi ofronte një pasqyrë të qartë jo vetëm të ofertës arsimore, por edhe të aftësive të nevojshme që përputheshin me kërkesat e sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.